

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Constitutional Articles: Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.
2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.

### Constitutional Paragraph: Neni 56.1

1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.

#### Instrumentet ndërkombëtare

#### Nenet

##### Neni 4.1

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike  
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

1. Në kohën kur një rrezik publik i jashtëzakonshëm kërcënon ekzistencën e kombit dhe shpallet zyrtarisht si i tillë, shtetet palë të këtij Pakti mund të marrin masa me të cilat shmangen detyrimet e parashikuara në këtë Pakt, në vëllimin përpikërisht të caktuar sipas kërkesave të situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në mënyrë të drejtës ndërkombëtare dhe të mos ngatërrojnë, si pasojë, një diskriminim të bazuar vetëm në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, ose origjin shoqëror.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj  
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

##### Neni 15.1

Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

1. Në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, vetëm për atë sa e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.

#### Ligjet

#### Nenet

LIGJI NR. 03/L-050 PËR  
THEMELIMIN E KËSHILLIT  
TË SIGURISË SË KOSOVËS  
LIGJI NR. 03/L-050 PËR  
THEMELIMIN E KËSHILLIT  
TË SIGURISË SË KOSOVËS

#### Neni 12

Misionet Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ushtron autoritet dhe përgjegjësi ekzekutive në emër të Qeverisë dhe sikurse është përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji, të kufizuar në kohë dhe në ato veprime të cilat konsiderohen të nevojshme për të tejkaluar atë situatë emergjente.

#### Neni 15

Pamundësia e mbajtjes së grevës

LIGJI Nr. 03/L-200 PËR  
GREVA  
LIGJI Nr. 03/L-200 PËR  
GREVA

1. Greva nuk mund të mbahet ose duhet të pezullohet në gjendje të jashtëzakonshme për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje.

2. Gjendje të jashtëzakonshme janë: fatkeqësitë natyrore, gjendja e luftës, epidemitë dhe rastet kur vihet në rrezik liria e zgjedhjeve.

**decisionTitle\***

**decisionDescription\***

**LAWLESS kundër IRLANDËS (kërkesa nr. 332/57) 1 korrik 1961 kjo çështje kishte të bënte me justifikimin e ndalimit të personave në përjashtim nga procedura normale për shkak të situatës së jashtëzakonshme**

z. Gerard Richard Lawless, i lindur në 1936, punonte në një ndërmarrje ndërtimi dhe banonte në Dublin. Më 21 shtator 1956, ai ndalohej, së bashku me tre burra, në një hangar të braktisur ku policia gjen armë. Gjykata Penale e qarkut të Dublinit dha vendimin për lirimin e katër të akuzuarve më 23 nëntor 1956. I dyshuar për veprimtari të paligjshme, z. Lawless ndalohej përsëri më 14 maj 1957. Gjatë një kontrolli në shtëpinë e tij, u gjet një dokument dorëshkrimor mbi guerilen. Më 16 maj, Gjykata Penale e qarkut të Dublinit e dënoi me një muaj heqje lirie për këtë fakt, por jo për anëtarësimin në IRA.

Në lidhje me nenin 15 . A bazohej paraburgimi i z. Lawless mbi të drejtën e derogimit të shteteve palë të garantuar nga neni 15 § 1? Gjykata shprehet pozitivisht, pasi kishte verifikuar se tre kushtet e kërkuara nga ky tekst ishin plotësuar. Në radhë të parë, qeveria mund të deklaronte, legjitimisht, se një rrezik publik i kanoset kombit gjatë periudhës në fjalë: në territorin e Republikës së Irlandës ndodhej një ushtri sekrete që vepronte jashtë kuadrit kushtetues dhe përdorte dhunë për të arritur objektivat e saj; kjo ushtri vepronte edhe jashtë territorit të shtetit, duke vështirësuar kështu marrëdhëniet e këtij të fundit me vendet fqinjë; aktivitetet terroriste ishin rritur në mënyrë alarmuese që nga vjeshta e vitit 1956 dhe gjatë semestrit të parë të vitit 1957.

LAWLESS kundër  
IRLANDËS  
(kërkesa nr. 332/57)  
1 korrik 1961

Nga ana tjetër vendimi sqaron edhe një sërë aspektesh të tjera konceptuale dhe procedurale që kanë të bëjnë me nenin 15 të Konventës dhe që kanë vlerë post factum edhe për situatën të vitit 1997 në Shqipëri. Vendimi sqaron konceptet e ‘emergjencës publike që kërcënon jetën e kombit’, parimin e proporcionalitetit në kuadrin e nenit 15, konceptin e detyrimeve të tjera në bazë të së drejtës ndërkombëtare<sup>276</sup>, si dhe aspektet procedurale të njoftimit për qëllimet e paragrafit 3 të nenit 15.

**Gjykata njëzëri deklaroi në pikën (iv) se: burgimi i z. G.R. Lawless nga 13 korriku deri më 11 dhjetor 1957 u themelua mbi të drejtën e derogimit të ushtruar në mënyrë të rregullt nga qeveria Irlandeze në përputhje me nenin 15 (neni 15) të Konventës si dhe**

**(v) thekson që komunikimi i adresuar nga Qeveria Irlandeze tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës më 20 korrik 1957 përbënte njoftim të mjaftueshëm në kuptim të nenit 15, paragrafi 3 (neni 15.3) i Konventës;**

Gary MARSHALL  
v. United Kingdom  
Application no.  
41571/98 10 July  
2001

Aplikanti ankohet se ndalimi i tij për shtatë ditë ka shkelur të drejtën e tij sipas nenit 5 § 3 të Konventës që të sillet menjëherë përpara një autoriteti gjyqësor. Për më tepër, ai pretendoi se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv për të sfiduar paraburgimin e tij para një gjykate vendase. Ai thirret në Nenin 13 në këtë drejtim.

Në një nivel më të përgjithshëm, aplikanti pohon gjithashtu se shteti i paditur është në kundërshtim me nenin 1 të Konventës, pasi me miratimin dhe vazhdimin e zbatimit të ligjit të vitit 1989 ata nuk kanë arritur të sigurojnë të drejtat e Konventës për lirinë dhe sigurinë e personit dhe për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit të tij. Është gjithashtu paraqitja e tij se mbajtja në fuqi e Aktit të vitit 1989 nuk mund të justifikohet më referencë në Nenin 15 të Konventës. Në këtë drejtim ai pohon se për momentin nuk ka emergjencë publike në Irlandën e Veriut. Ai pretendon në alternativë se edhe nëse ka një emergjencë publike, derogimi i bërë nga Shteti i paditur nuk kërkohet rreptësisht nga kërkesat e situatës aktuale dhe është në kundërshtim me detyrimet e tjera ndërkombëtare të atij shteti. ***Për këtë arsye edhe ankuesi pohon se shteti i paditur është në kundërshtim me nenin 15 të Konventës.***

**Duke marrë parasysh deklaratat e mësipërme, Gjykata konkludon se shmangia e kundërshtuar i plotëson kërkesat e nenit 15 dhe se paditësi pra nuk mund të ankohet në mënyrë të vlefshme për një shkelje të nenit 5 § 3. Përfundoi më tej se nuk ekziston ndonjë shkelje e nenit 13.**

**Për këto arsye, Gjykata njëzëri e deklaroi kërkesën si të papranueshme.**